



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Procesverbali i përgjithshëm për mbajtjen e 9 dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Përmbajtja:

Tabelori me të dhëna të shkurtëra për dëgjime buxhetore-----	3
Të dhëna të përgjithshme për organizimin e dëgjimeve-----	4
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Reqan me banor të fshatrave të Zhupës-----	5-6
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Korishë-----	7-9
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Gjonaj me banorë të rajonit të Hasit-----	10-14
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Piranë-----	15-17
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Velezhë-----	18-20
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Zhur-----	21-23
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Vlashnje-----	24-26
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me gra, buxhetimi gjinor, të rijnë, pensionistët dhe OJQ-----	27-29
Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik i përgjithshëm-përfundimtarë me qytetarë dhe kryetar të këshillave të fshatrave dhe lagjeve-----	30-36
Përfundimi-----	37

Tabelori me të dhëna të shkurtëra për dëgjime buxhetore:

Nr	Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve	Numri i kërkesave
1	-Dëgjimi Publik në Reqan me banorë të rajonit të Zhupës -Objekti i shkollës në Reqan -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/	18.07.2024	F 1 M 16 T 17	8
2	-Dëgjimi Publik në Korishë, Lutogllavë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorobisht, Gërnqarë, Dojnicë dhe Novosellë -Objekti i shkollës në Korishë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/	18.07.2024	F 1 M 25 T 26	17
3	-Dëgjimi Publik në Gjonaj me banorë të rajonit të Hasit -Objekti i shtëpisë së kulturës në Gjonaj -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzehes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/	22.07.2024	F 11 M 47 T 57	68
4	-Dëgjimi Publik në Piranë, Zojz, Medvec, Landovicë, Arbanas, Krushë e Vogël, Randobravë -Objekti i shkollës në Piranë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzehes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/	22.07.2024	F 0 M 17 T 17	14
5	-Dëgjimi Publik në Velezhë Shpenadi, Caparc, Trepeticë, Serbicë e Epërme dhe Novakë -Objekti i shkollës në Velezhë -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzehes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/	22.07.2024	F 0 M 14 T 14	19
6	-Dëgjimi Publik në Zhur, Vërmicë, Shkozë, Dobrusht -Objekti i shkollës në Zhur -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-planifikon-te-realizon-projekte-cilesore-ne-rajonin-e-zhurit-dhe-vlashnjes/	23.07.2024	F 1 M 24 T 25	30
7	-Dëgjimi Publik në Vlashnje, Hoçë e Qytetit, Jeshkovë, Malesi e Vërrinit, Poslisht, Billushë, Vlashnje, Kobaj, Grazhdanik, Atmaxhë -Objekti i shkollës në Vlashnje -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-planifikon-te-realizon-projekte-cilesore-ne-rajonin-e-zhurit-dhe-vlashnjes/	23.07.2024	F 2 M 12 T 14	28
8	-Dëgjimi buxhetor me gra, buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistët dhe OJQ -Shtëpia e Bardhë-Prizren -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-degjon-kerkesat-e-organizatat-e-shoqerise-civile/	08.08.2024	F 9 M 17 T 26	10
9	-Dëgjimi i përgjithshëm-përfundimtarë me qytetarë dhe kryetar të këshillave të fshatrave dhe lagjeve -Shtëpia e Bardhë-Prizren -Lajmi për mbajtjen e dëgjimit: https://kk.rks-gov.net/prizren/news/kryetari-totaj-permbyll-dhjet-degjimet-buxhetore-per-vitin-2025/	09.08.2024	F 5 M 60 T 65	88
			Femra-----:30	Nr i përgjithshëm: 286
			Meshkuj:-:232	
			Totali-----:262	

Të dhëna të përgjithshme për organizimin e dëgjimeve:

Këto procesverbale janë përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 19.01.2024, kryetari i komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2025-2027 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2025. Përbërja e këtij grupi është: Zenel Ahmetaj, kryesues; Halil Lika, zëvendës kryesues; Gjafer Ponik, anëtar-procesmbajtës; Fejsal Hoti, anëtar; Naim Kukaj, anëtar; Ymer Berisha, anëtar dhe Haziz Krasniqi, anëtar.

Me 03.07.2024, janë publikuar dokumentet në web, platformë dhe në rrjetin social facebook. Njoftimi në web:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Kalendari-Njoftimet-per-degjime-buxhetore-publike-per-buxhetin-e-vitit-2025-Shq-Bosh-Tur-Rom-PDF-SCAN-Final.pdf>

Njoftimi në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42528>

Njoftimi në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/EznHAJKVE3p1keHh/?mibextid=oFDknk>

Lajmi në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/kalendari-i-degjimeve-publike-per-pergatitjen-e-buxhetit-te-komunes-se-prizrenit-per-vitin-2025/>

Me 04.07.2024:

Kalendari-Njoftimi përmes emailit u është dërguar : Drejtorëve të shkollave fillore-publike; drejtorëve të shkollave të mesme-publike; drejtorëve të shkollave private; pedagog, psikolog, mësime-dhënë, mbështetës në shkollat fillore dhe të mesme; sekretarëve të shkollave të punësuar në institucione arsimore; policia, zjarrfikës, biznese; OJQ për mirëqenie, OJQ për barazi gjinore; institucione shëndetësore (QKMF, QMF dhe AMF) dhe OJQ të ndryshme.

Përmes grupit të formuar në rrjetin social viber, njoftimi dhe materialet që kanë të bëjnë me dëgjime buxhetore u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Prizrenit.

**Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me banor të fshatrave: Reqan, Struzhë, Pouskë, Jabllanicë, Llokvicë, Manasterice, Nebregosht, Zhiviniane, Pllaniane, Bogoshefc, Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë ,Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe
Drajqiç**

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/1-Njoftim-per-degjim-buxhetor-me-banor-te-Rajonit-te-Zhupes-Reqan.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-zhupes-per-organizimin-e-degjimit-buxhetor-per-pergatitjen-e-buxhetit-te-vitit-2025/>

Me 13.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për rajonin e Zhupës:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Zhupes-2025-2027.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi me banor të rajonit të Zhupës gjegjësisht fshatrave: Reqan, Struzhë, Pouskë, Jabllanicë, Llokvicë, Manasterice, Nebregosht, Zhiviniane, Pllaniane, Bogoshefc, Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë ,Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe Drajqiç i mbajtur me datë 18.07.2024.

Dëgjimi ka filluar në orën: 18:40

Hapja e takimit është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqësi i njësisë për Komunikim me Publikun i cili ka thënë se kemi kënaqësinë që jemi sëbashku me ju, kryetarin Shaqir Totaj ka kërkuar që ta hapim politikën më të madhe publike, pra buxhetin për vitin 2025. Ju njoftoj se njoftimet janë bërë me kohë në gjuhët zyrtare, janë publikuar në webfaqe, rrjetin social të komunës gjithashtu njoftimi është dërguar edhe tek kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve. Zyrtarët përgjegjës, do të mbajnë shënime, dhe do të përgatisin procesverbal dhe raport të njëjtit më pas do të publikohen në webfawen zyrtare. Për këtë vit është planifikuar të mbahen 11 dëgjime buxhetore, kërkesat Ju mund ti dërgoni edhe përmes emailave zyrtar, kërkesat tuaja do të trajtohen dhe do të merrni përgjigje për secilën kërkesë.

Kryetari, Shaqir Totaj ka thënë se jemi këtu që ti marrim kërkesat apo nevojat që ju i keni, e di që të gjitha kërkesat nuk do të mund ti fusim në buxhet por ju kërkesat ti bëni duke u bazuar në prioritetet që ju i keni, dhe më pas ne sipas mundësive buxhetore kërkesat tuaja ti fusim në buxhet. Ne kemi investuar këtu, por që sigurisht që do të vazhdojmë edhe më tutje.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe Financa i cili ka prezantuar buxhetin e paraparë për vitin 2025, buxhetin të cilin ju mund ta shihni përmes video projektorit është i hartuar duke u bazuar në qarkoren e ministrisë së financave, pra ministria përmes qarkores na i ka caktuar tavanet buxhetore, buxheti për vitin 2025 është : Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve:

- **Bashkim Bajrami**-Rehabilitimi i rrugës prej Sredskës deri në Drajçiq.
- **Amir Bajrami**-Të ketë kujdestari nga zjarrëfikësit,
 1. Përfundimi i aneksësit të ambulancës,
 2. Largimi i rampës në rrugën Prizren-Prevallë,
 3. Rregullimi i rrugës Reqan Lubinjë.
- **Bashkim Bajrami**-Kubëzimi i rrugëve brenda fshatit Drajçiq.
- **Ismet Rustemoviç**-Zgjidhja për zyret lokale dhe dhënja e vulës.
- **Halit Karadollami**-Shtrimi me asfalt i 100 m² rrugës ne hyrje të fshatit Lubinje e Poshtme.

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 18:40

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund ti gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund ti gjeni ne këtë vegez: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra---:1

Meshkuj:16

Totali---:17

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me banor të fshatrave: Korishë, Lutogllavë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorobisht, Gërnqarë, Dojnicë dhe Novosellë

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Korishes-2025-2027.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-korische-malesi-e-re-lubizhde-skorrobisht-dhe-gernqar-si-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-buxhetor-per-pergatitjen-e-buxhetit-te-vitit-2025/>

Me 13.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për rajonin e Korishës: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Korishes-2025-2027.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi me banor të fshatrave të rajonit të Korishës, gjegjësisht fshatrave: Lutogllavë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorobisht, Gërnqarë, Dojnicë, Novosellë i mbajtur me datë 18.07.2024

Dëgjimi ka filluar në orën: 19:40

Ymer Berisha, udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun ka hapur dëgjimin edhe në fshatin Korishë duke thënë se në këtë dëgjim publik jemi bashkë me Ju që të diskutojmë për buxhetin e vitit 2025, zyrtarët komunal përgjegjës janë duke mbajtur shënime dhe do të përgatisin procesverbalin dhe raportin dhe më pas këto dokumente do të publikohen në webfaqe dhe më pas ju mund ti shihni kërkesat tuaja.

Kryetari Shaqir Totaj, ka thënë se jemi këtu që të marrim kërkesat tuaja për vitin 2025. Për vitin 2025 buxheti për investime kapitale do të jetë 21 milion euro, e dimë që kërkesat dhe nevojat janë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore, por që ju renditni kërkesat tuaja sipas prioriteteve. Takime të tilla ne do të kemi edhe në të ardhmen, dhe në këto takime ju përsëri do të keni mundësinë që të diskutojmë për kërkesat tuaja, të gjitha kërkesat tuaja janë të arsyeshme por që ne do të shohim edhe mundësitë buxhetore duke u bazuar edhe në prioritete.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe Financa ka thënë se para juve ne sot po e paraqesim buxhetin e komunës së Prizrenit, apo politikën më të rëndësishme që e miraton kuvendi komunal i Prizrenit. Sipas qarkores buxhetore të ministrisë së financave, buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0 .

Kërkesat e qytetarëve:

- Abaz Bobaj
 1. Rregullimi i shtratit të lumit dhe kanalizimi.
 2. Nderimi i shtëpis se Kulturës.
 3. Perfundimi i rregullimit të varrezave të martirëve.
 4. Rregullimi i kanalizimit në Lutogllav.
- Adem Ndrecaj
 1. Kryerja e ndertimit të shkollës në Lutogllavë.
 2. Zgjedhja e qështjes së ujit në Malësi të re.
 3. Shtrimi me asphalt dhe ndertimi i varrezave.
 4. Ndriqimi Publik.
- Sejdi Tafaj
 1. Rregullimi dhe furnizimi me ujë të pijes në Lutogllavë.
- Sami Kabashi
 1. Ndërtimi i bazenit për ujë të pijes te Laxheja të Xhamia
- Hasan Ahmetaj
 1. Pastrimi i shtratit të lumit nga Shkolla Mehmet Akif.
- Ilir Xhaferi
 1. Shtruarja e dysHEMEVE te klasave.
 2. Lyerja e hapsirës së brendshme të shkollës.
 3. Izolimi i jashtëm i shkollës.
 4. Rregullimi i kulmit të sallës sportive.
- Rexhep Bobaj
 1. Uji i pijes të futet në sistemin e hidroregjionit.
 2. Rregullimi i shtratit të lumit në fund të fshatit.
 3. Rregullimi me fontan i 4 vareve të xhamia.

Dëgjimi ka përfunduar në orën 20:45.

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund ti gjeni në këtë veçez: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund ti gjeni ne këtë veçez: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra---:1

Meshkuj:25

Totali---:26

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me banor të Rajonit të Hasit

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/3-Njofitim-per-degjim-buxhetore-me-banor-te-Rajonit-te-Hasit-Gjonaj.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njofitim-per-banoret-e-fshtrave-te-rajonit-te-hasit-per-organizimin-e-degjimit-buklik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025/>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 17:40

Ymer Berisha, shef i njësisë për komunikim me publikun, ka hapur dëgjimi duke thënë se kryetari i komunës nga kabineti i tij kanë dalë që ti marrin kërkesat tuaja. Pra ne sot jemi këtu për t'ju dëgjuar juve dhe nga ju ti marrim kërkesat dhe nevojat që ju i keni. Zyrtarët përgjegjës, do të mbajnë shënime dhe do të përgatisin procesverbal dhe raport me të gjitha detajet.

Shaqir Totaj, ka thënë se ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në dëgjime buxhetore, kjo praktikë është praktikë e mirë dhe në po e vazhdojmë, pra sot jemi këtu që ti marrim kërkesat tuaja, por mirë është që ti bëni kërkesat sipas prioriteteve që ju keni. E di që kërkesat apo nevojat janë më të mëdha se sa që kemi mundësi por që ne do ti shohim mundësitë buxhetore dhe kërkesat duke u bazuar në prioritete do të jenë pjesë e buxhetit për vitin 2025.

Zenel Ahmetaj, zyrtar kryesor financiar ka thënë se buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0 .

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:
12.07.2024

Bekim Nurbojaj, kryetar i këshillit të fshatrave: Lubizhdë e Hasit dhe Dedaj, jomë këtu për ti paraqitur kërkesat për dy fshatrat, kërkesat janë renditur sipas prioriteteve dhe nevojave të banorëve:

1. Ndërtimi i proçkës së fshatit e cila kalon nëpër mes fshatit me gjatësi të përafërt 1 kilometër, me rregullimin e kësaj proçkë, do të evitohet përmbytja në këtë fshat.
2. Ndërtimi i një aneksi të shkollës pasi që shkolla jonë ende punon me dy ndërrime, rregullimi i këtij aneksi do të lehtësoj punën e mësimeve dhe do të ketë mësim më efektiv.
3. Rregullimi i rrugëve në disa lagje të Lubizhdës së Hasit, do të lehtësoj qarkullimin e banorëve të cilët jetojnë në këtë fshat.

4. Rregullimi i sistemit të ujit të pijes në fshatin Dedaj, ky rregullim do të na mundësoje që të mos shkojmë me marr ujë diku tjetër por që të kemi secili në shtëpinë e tyre.
5. Rregullimi i oborrit të shkollës, do të ofroj kushte më të mira për nxënësit sigurisht dhe për personelin e shkollës.
6. Rrethimi dhe ndërtimi i një fushe sportive në fshatin Dedaj, ky projekt do të ofroj kushte të mira për secilin nxënës dhe mësimdhënës në mënyrë që aktivitetet sportive ti realizojnë ashtu edhe siç kërkohet.
7. Rregullimi i 2 kilometrave rrugë në fshatin Dedaj, do të na lehtësoj lëvizjen më të mirë për të gjithë banorët.

Mustaf Totaj, banor i fshatit Gjonaj, unë e kam një kërkesë dhe ajo është e një rëndësie të madhe për banorët që e frekuentojnë atë rrugë:

1. kërkesë për 930 m rruge për te shkuar deri tek fusha e sportit ne fshat.

Bedri Osmanollaj- fshati Gjonaj, kërkesat e mia janë edhe të banorëve të cilët jetojnë në këtë pjesë dhe ato janë:

1. Ndërtimi i rregullimit te rrugës kryesore ne fshatit Gjonaj.
2. Ura e fshatit ne Gjonaj
3. Ndriçim publik

Shani Taraj – fshati Mazrek Milaj Gorozhup, është investuar në këtë pjesë por që ne kemi kërkesa tjera dhe që prekin mirëqenies e qytetarëve të kësaj ane, kërkesat janë:

1. Rregullimi i infrastrukturës
2. kërkesë për ujë te pijes ne fshatit Mazrek

Hil Gjevelekaj -fshati Karashengjergj, kam një kërkesë e që mendoj që është e rëndësishme për banorët e kësaj ane:

1. kërkesë për rregullimin e kanalizimit ne lagjen Gjevelekaj

Marte Prekpalaj- fshati Zym, në të vërtet është investuar si asnjëherë më pare në këtë pjesë dhe për këtë u jemi falenderues pasi që është lehtësuar lëvizja e banorëve, por që kërkesat e mia janë këto:

1. Rregullimi i rrugës tek lagjja Cakaj
2. Rregullimi i oborrit te shkollës ne Breg Drini

Ismet Cakaj- fshati Karashengjergj, që të mos e zgjas më shumë kërkesat për fshatin tone janë këtë:

1. Rregullimi i rrugës tek lagjja Cakaj
2. Ndriçimi publik
3. kërkesë për mjet transportues

Hajdar Temaj- fshati Kushnin, kërkesat që do ti parashtrroj para jush janë të një rëndësie për banorët e fshatit dhe me realizimin e këtyre projekteve sigurisht që do të na lehtësohet lëvizja në këtë pjesë:

1. Rregullimi I kanalizimit ne fshatin Kushnin

2. Vendosja e shenjave te komunikacionit tek ura e fshatit

Egzona Hoxha- fshati Gjonaj, unë kërkesat do ti bëjë edhe në kuvend komunal por që e rëndësishme është që të ndërtohet një çerdhe pasi që ka kërkesa dhe është shumë e nevojshme për prindërit të cilët jetojnë në rajonin e Hasit dhe që punojnë:

1. Ndërtimi i kopshtit te fëmijëve ne Has

Bajram Braha-Gjonaj ne kemi nevojë që të kemi përkrahje për bujqësi dhe për këtë anë është e rëndësishme që të investohet në sektorin e bujqësisë, kërkesa ime është:

1. Hapja e vijave bujqësore

Rame Himaj-fshati Romaje, kërkesat që do ti parashtroj janë të renditura sipas prioriteteve dhe kemi menduar që janë të një rëndësie të veçanta për këtë zone, kërkesat janë këto:

1. Rregullimi i rrugës kryesore ne fshatin Romaje
2. Zgjidhja e problemit tek varrezat e fshatit
3. Pastrimi i kanaleve te rrugës

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 18:35

Kërkesat e qytetarëve të pranuar në formë elektronike: Është pranuar një kërkesë.

Kërkesat e pranuar nga Herolind Osmanollaj, kryetar i këshillit të fshatit Gjonaj dhe Tupec (12.07.2024) të pranuar në formë elektronike, kërkesat janë të ndara sipas drejtorive, sigurisht që janë të ndara edhe sipas rëndësisë dhe prioriteteve, realizimi i secilit nga këto projektet do të ndikoj direkt në jetën e secilit qytetarë pasi që kërkesat kanë të bëjnë me kulturë, rini dhe sport, shëndetësi, administratë, shërbime publike, emergjencë dhe siguri.

Më poshtë i gjeni kërkesat e ndara sipas drejtorive dhe që janë për dy fshatra Gjonaj dhe Tupec:

Gjonaj

Kërkesat për DKRS-në:

1. Rregullimi i zhveshtorëve dhe tribunave në stadiumin në fshatin Gjona,
2. Rregullimi dhe mirëmbajtja e Memorialëve të Dëshmorëve të Kombit “Zenun Çoçaj”-Gjonaj dhe “Reshat Çoçaj”-Tupec,
3. Gurra e fshatit Gjonaj, të hyjë nën mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Kërkesat për Shëndetësi:

1. Hapja e konkursit për Stomatolog në QMF-Gjonaj,
2. Në QMF-Gjonaj të punohet me dy ndërrime,
3. Një (1) Autoambulancë për QMF-Gonaj.

Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri

1. Aktivizimi i Njësisë së Zjarrfikëseve në fshatin Gjonaj.

Drejtoria për Shërbime Publike:

1. Rregullimi i rrugëve kryesore Gjonaj-Mazrek,
2. Rregullimi i kanalizimit në disa lagje të fshatit,
3. Ndriçimi dhe trotuari në të gjithë fshatin Gjonaj,
4. Hapja e kanaleve të hapura dhe intervenimi i tyre,
5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve nga shkurret,
6. Dy anësore mbrojtëse, te Ura në hyrje të fshatit Gjonaj si dhe te Kodra e Pajtimit,
7. Rregullimi i rrugëve lokale në fshat,
8. Rregullimi i rrugës së vjetër Gjonaj-Zym.

Drejtoria e Administratës:

1. Hapja e një konkursi për Zyrën e Gjendjës Civile në fshatin Gjonaj.

Tupec

Drejtoria për Shërbime Publike:

1. Rregullimi i rrugëve lokale në fshatin Tupec,
2. Rregullimi i kanalizimit në disa lagje të fshatit,
3. Zgjerimi i rrugës te “ShFMU Zenun Çoçaj-Tupec,
4. Ndriçimi dhe trotuari në të gjitha rruget e fshatit Tupec,
5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve nga shkurret,
6. Rregullimi i vijës së ujit në tokat bujqësore-Tupec,
7. Rregullimi i ujit të vadës në fshat,
8. Intervenimi i ujërave të zeza në Toka Bujqësore, që vijnë nga Prizreni.

Kërkesat e njëjta janë përsëritur edhe në dëgjimin e mbajtur me 22.07.2024.

Leonit Çoçaj, banor i fshatit Gjonaj (29.07.2024).

Duke marrë parasysh procesin e dëgjimeve buxhetore të cilat po zhvillohen këto ditë në mbarë Komunën e Prizrenit, përmes kësaj shkrese po u drejtohem me disa pika të cilat derivojnë nga kërkesat e banorëve të lagjes Brejzë dhe gjithë banorëve të fshatit Gjonaj.

Disa nga kërkesat kryesore sipas prioriteve janë:

1. Ndriçimi publik në mbarë fshatin Gjonaj;
2. Rregullimi i trotuareve në mbarë fshatin Gjonaj;
3. Vendosja e pengesave rrugore në hyrje të fshatit Gjonaj;
4. Ndriçimi publik në rrugën Miniera e Gjonajve;
5. Rehabilitimi i rrugës kryesore Gjonaj – Mazrek;
6. Rehabilitimi i kubëzave në rrugën Miniera e Gjonajve;
7. Rregullimi i 2 rrugëve të reja me kubëza në kuadër të rrugës Miniera e Gjonajve, duke përfshirë edhe rregullimin e murit mbrojtës në rrugët përkatëse;

8. Rehabilitimi i ujërave të shiut që vjen nga mali në oborret e shtëpive në lagjen Miniera e Gjonajve;
9. Vendosja e murit mbrojtës në vende ku ka shtëpi dhe rrezikohen nga shembja e dheut në lagjen Miniera e Gjonajve;
10. Të sigurohet sistemi i ujitjes për fshatin Gjonaj – Sistemi i Vades;
11. Të vendosen kamerat e sigurisë në zonat qendrorë të fshatit Gjonaj, etj.

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra---:11

Meshkuj:47

Totali---:57

Projekt buxheti për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, u është prezantuar qytetarëve të pranishëm në dëgjim edhe përmes video projektorit si dhe u është shpërndarë edhe në formë fizike.

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe planifikimet për vitet 2026/2027, mund ta gjeni të publikuar edhe në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-te-Hasit-2025-2027.pdf>

Lami për mbajtjen e dëgjimit: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzehes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/>

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Piranë, Zojz, Medvec, Landovicë, Arbanas, Krushë e Vogël, Randobravë

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/4-Njofitim-per-degjim-buxhetoper-banor-te-rajnit-te-Podgurit-Pirane.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njofitim-per-banoret-e-fshtrave-pirane-zojz-medvec-landovice-arbanas-krushe-e-vogel-randobrave-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025/>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 19:10

Ymer Berisha, shef i njësisë për komunikim me publikun, ka hapur dëgjimi duke thënë se kryetari i komunës, Shaqir Totaj, me të gjithë strukturën e tij është sot këtu për t'ju dëgjuar kërkesat që ju i keni dhe më pas ato kërkesa, sipas mundësive buxhetore do të hynë në buxhetin e vitit 2025. Edhe për këtë dëgjim zyrtarët komunal do të mbajnë shënime dhe do të përgatisin procesverbal dhe raport me të gjitha detajet që kërkohen.

Shaqir Totaj, kryetar ri komunës i ka faleminderit gjithë të pranishmit në dëgjim publikë duke thënë se jemi këtu që ti marrim kërkesat tuaja dhe sipas mundësive buxhetore do ti fusim në buxhetin e vitit 2024. Buxheti është i ndarë në disa kategori por që ajo e cila është më e rëndësishme është investimet kapitale e që për vitin 2025 komuna do të ketë 21,425,881.00. Mirë do të ishte që kërkesat ti renditni sipas prioriteteve që ju i vlerësoni.

Zenel Ahmetaj, zyrtar kryesor financiar ka thënë se buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Skender Elshani, kryetar i këshillit të fshatit: Piranë, Sërbicë e Poshtme, Medvec dhe Zojz, aktualisht është duke u punuar në disa projekte, por që sigurisht që ne kemi kërkesa për realizimin edhe të projekteve tjera e që kanë për qëllim rritjen e cilësisë së jetës së banorëve që jetojnë nëpër këto fshatra, kërkesat janë këto:

1. Rregullimi i një çerdhe publike,
2. Rregullimi i rrugëve me kubëza në fshat,
3. Rregullimi i ndriçimit publik,
4. Rregullimi i kanalizimeve,
5. Rregullimi i terreneve sportive (me bari sentetik)

Bislim Krasniqi- fshati Medvec, banorët e fshatit prej nga vij unë e rëndësishme është që të realizohen disa projekte e që prekin sigurinë dhe lëvizjen e sigurisë, këto janë kërkesat:

1. Rregullimi i rrugës Medvec-Smac
2. Ndriçimi publik

Nagip Morina fshati Landovice, kërkesat e fshatit janë:

1. Rehabilitimi i rrugëve ne Landovice
2. Hapja e rrugësve fushore

Durak Thaqi- fshati Zojz, mendoj që për rinin e fshatit mire është të investohet në sport pasi që kemi mungesë të investimeve në këtë aspekt, kërkesa ime është:

1. Ndërtimi i një fushe te sportit ne fshatin Zojz

Liridon Bytyqi-fshati Pirane, e rëndësishme është që të investohet në përgjithësi ku preket mirëqenia dhe siguria e qytetarëve, kërkesa ime është:

1. Rregullimi i infrastrukturës

Mustafe Daqi -fshati Pirane, si zonë bujqësore që jemi mendoj që investimi në këtë sektor do të ishte i qëlluar dhe rrjedhimisht do të motivonte bujqit që të merren me këtë sektor, kërkesa ime është:

1. Kërkesë për investimi ne bujqësi dhe blegtori

Shefki Mustafa-fshati Randobrave, janë duke u realizuar projekte në fshatin tonë, por sigurisht që ne kërkojmë që të vazhdohet apo të planifikohen edhe projekte të tjera për vitin 2025, kërkesa është:

1. Rregullimi i proçkës

Ermal Shehu- fshati Krushe e Vogel, nuk kam ndonjë kërkesë specifike jemi duke e pare që është duke u punuar, por kërkesa ime është :

1. Finalizimi i rregullimit te varrezave deri me 31 gusht 2024.

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 19:40

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra----:0

Meshkuj:17

Totali----:17

Projekt buxheti për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, u është prezantuar qytetarëve të pranishëm në dëgjim edhe përmes video projektorit si dhe u është shpërndarë edhe në formë fizike.

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe planifikimet për vitet 2026/2027, mund ta gjeni të publikuar edhe në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-te-Piranes-2025-2027.pdf>

Lami për mbajtjen e dëgjimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzhes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/>

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimi publik në Velezhë , Shpenadi, Caparc, Trepeticë, Serbicë e Epërme dhe Novakë

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/5-Njoftim-per-degjim-buxhetore-me-banor-te-fshatrave-Shpenadi-Caparc-Trepetice-Serbice-e-Eperme-Novak-Velezh.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshtrave-velezhe-shpenadi-caparc-trepetice-serbice-e-eperme-dhe-novake-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025/>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 20:20

Ymer Berisha, shef i njësisë për komunikim me publikun ka thënë se në këtë dëgjim publikë të pranishëm janë struktura më të larta. Në këtë dëgjim fjalën do të keni ju për ti parashtruar kërkesat që ju keni dhe më pas ato kërkesa sipas mundësive buxhetore do të hyjnë në buxhetin e vitit 2025. Për këtë dëgjim publik, zyrtarët komunal janë duke mbajtur shënime dhe të njëjtit do të hartojnë procesverbal dhe raport me të gjitha detajet e nevojshme.

Kujtim Gashi, nënkryetar i komunës së Prizrenit se për shkak të agjendës, kryetari nuk është sonte me ne, por që ne jemi këtu për ti marrë kërkesat që ju keni, dhe se buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Pjeter Perlazi- fshati Velezhe , është shumë e rëndësime që të investohet në infrastrukturë në këtë pjesë, pasi që është edhe e nevojshme dhe sigurisht që të ndikon në jetën e gjithë banorëve të kësaj ane, kërkesat janë:

1. Kërkesë për rrethoje te lumit me mur mbrojtës
2. Ndriçimi publik
3. Rehabilitim i rrugës Perlazi ne fund te fshatit
4. Rregullim i kanalizimit te ujerave te zeza ne fshati Trepetnice
5. Hapja e rrugëve fushore

Fshati Smac-

1. Përfundimi i projekteve te filluara
2. Rregullim i infrastrukturës
3. Rregullimi i urës
4. Hapja e kanalizimeve me beton

5. Rrjeti elektrik

Agron Kuzhnini- fshati Shpenadi, kemi menduar që të vazhdohet me përmirësimin e infrastrukturës së fshatit, pasi që me investime në infrastrukturë do të rritet edhe siguria e lëvizjes së banorëve që jetojnë në këtë pjesë, kërkesat janë:

1. Kërkesë për ujë të pijshëm
2. Rregullimi i rrugicave me kubeza

Gjergj Shtufi –fshati Shpenadi, kërkesa ime dhe e banorëve të fshatit është jetike, dhe mendoj që nuk ka nevojë edhe për argumentim, pra kërkesa ime është:

1. Kërkesë për ujë të pijshëm

Nue Çollaku-Capar, kam kërkesa që mendoj që janë të përballueshme për buxhetin e komunës, kërkesat janë:

1. Kërkesë për pastrues ne shtëpinë e shëndetit ne fshat
2. Rregullimi i rrugës dhe kanalizimit para shkollës në fshatin Caparc

Bekim Thaqi

1. Haja e rrugëve fushore
2. Rregullimi i rrugës për tek varrezat

Simon Veseli- fshati Shpenadi, kam dy kërkesa dhe ato janë të rëndësishme për banorët e fshatit prej nga jam edhe unë, mendoj se nuk kam nevojë për të argumentuar edhe shumë, kërkesat e mia janë:

1. Kërkesë për 450m kubeza
2. Kanalizim 300m

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 20:55

Kërkesat e qytetarëve të pranuar në formë elektronike: Nuk është pranuar asnjë kërkesë.

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra----:0

Meshkuj:14

Totali---:14

Projekt buxheti për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, u është prezantuar qytetarëve të pranishëm në dëgjim edhe përmes video projektorit si dhe u është shpërndarë edhe në formë fizike.

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe planifikimet për vitet 2026/2027, mund ta gjeni të publikuar edhe në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-Velezhe-2025-2027.pdf>

Lami për mbajtjen e dëgjimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/banoret-e-fshatrave-te-rajonit-te-hasi-piranes-e-velzhes-i-dhane-propozimet-e-tyre-per-buxhetin-e-vitit-2025/>

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Zhur, Vërmicë, Shkozë, Dobrusht

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/6-Njoftim-per-degjim-buxhetore-me-banor-te-fshatrave-Vermice-Shkoze-Dobrusht-Zhur.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshtrave-velezhe-shpenadi-caparc-trepetice-serbice-e-epërme-dhe-novake-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025/>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 18:10

Ymer Berisha, udhëheqës i njësisë për komunikim me publikun ka thënë se edhe në këtë dëgjim buxhetorë për ti marrë kërkesat tuaja që ju i keni dhe më pas ato kërkesa duke u bazuar edhe në mundësitë buxhetore do të hynë në buxhetin e vitit 2025. Që të kemi arkivë për organizimin e dëgjimeve buxhetore, zyrtarët përgjegjës do të mbajnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe raport me të gjitha detajet dhe të njëjtat do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës së Prizrenit.

Shaqir Totaj, kryetar i komunës ka thënë se ne kemi realizuar projekte por që tani jemi në fazën e hartimit të buxhetit për vitin 2025 dhe arsyeja se pse ne kemi këtu është që ti marrim kërkesat, apo nevojat që ju i keni , pasi që më mirë se sa ju që i dini nevojat tuaja nuk i dinë askush tjetër. Të gjitha kërkesat tuaja janë të arsyeshme, por që ne do të shohim edhe mundësitë buxhetore, sigurisht që sipas prioriteteve që ju i caktoni ne do ti fusim edhe në buxhetin e vitit 2025, sigurisht që të gjitha kërkesat tuaja nuk do të mund të futen në buxhet, pasi që buxheti për investime kapitale është 21 milion euro.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe Financa ka thënë se ky projekt buxhet është i bazuar në qarkoren buxhetore të lëshuar nga ministria e financave dhe përmes kësaj qarkoreje, na janë vendosur edhe kufit buxhetorë dhe ky projekt buxhet është i ndarë në disa kategori buxhetore dhe se buxheti total do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Jakup Hoxhaj, kryetar i fshatit Zhur, komuna është duke realizuar projekte në fshat por që kemi edhe kërkesa tjera të cilat janë edhe nevoja të banorëve që jetojnë në këtë fshat, kërkesat janë:

1. Përfundimi i shtëpisë së kulturës, ky objekt është i stërzgjatë dhe mirë është që të përfundoj si projekt pasi që edhe kemi nevojë si fshat.

2. Asfaltimi i rrugës kryesore të fshatit, siç edhe keni mundur të shihni, rruga është e dëmtuar andaj nëse veç e renovoni-rregulluno do të ishte në të mirën e gjithë banorëve të këtij fshati.
3. Ndërtimi i një çerdhe në fshat, çdo ditë e më shumë po rritet kërkesa për të pasur një çerdhe në fshat, kjo është edhe kërkesë e banorëve të këtij.

Bujar Pulaj, kryetar i këshillit të fshatit Vërmicë, Shkozë dhe Dobrusht

Vërmicë:

1. Ndriçimi publik, do të lehtësoj lëvizjen e banoreve dhe do të rrit sigurinë.
2. Renovimi i shtëpisë së kulturës, do të mundësoj zhvillimin e aktiviteteve kulturore në këtë objekt.
3. Rregullimi i trotuarit rreth rrugës magjistrale duke filluar nga kufiri deri tek shkolla rreth liqenit, do të rris sigurinë për banorët e këtij fshati.

Shkozë:

1. Rregullimi i kanalizimit tek shkolla fillore, do të largoj erën e keqe që vije nga mos pasja e kanalizimeve.
2. Ndriçimi publik te kompletohet dhe të mirëmbahet (pasi që një pjesë është), do të rris sigurinë e lëvizjes dhe sigurinë e banorëve.
3. Rregullimi i disa rrugëve me kubëza, do të lehtësoj lëvizjen e banorëve në këtë fshat.

Dobrusht:

1. Ndriçimi publik, do të rris sigurinë e lëvizjes.
2. Rregullimi i rezervarit të ujit, do të mundosjë që të ketë ujë më cilësor për banorët e këtij fshati
3. Rregullimi i kanalizimit në ato pjesë ku mungojnë, do të largoj erën dhe do të lehtësoj jetën e banorëve të këtij fshati.
4. Rregullimi i rrugëve me kubëza, do të lehtësoj lëvizjen e banorëve të këtij fshati.

Tahir Elezkurtaj- fshati Zhur

1. Shtëpia e kulturës nuk është e ndërtuar ne baze te projektit
2. Meremetimi i lapidarit nuk është ne rregull

Esat Gutaj-fshati Dobrushte, është investuar por që janë edhe disa projekte që duhet të realizohen e që janë të rëndësishme për gjithë banorët, pra kërkesat e mia janë:

1. Rregullimi i pronave te uzurpuara
2. Hapja e rrugëve ne fshatin Muradem
3. Ndriçimi publik
4. Kanalizim
5. Rregullim i infrastrukturës

Pranver Asllani-fshati Zhur, kërkesat e mia janë:

1. Aktivizimi i ambulancës 24h edhe weekendeve
2. Rrethoje për varreza
3. Kërkesë për bartje e nxënësve
4. Aktivizimi i zjarrfikësve
5. Kërkesë për pastrimin e fshatit, jo vetëm tek qendra

Misin Gutaj-fshati Dobrushte, për banorët e fshatit është e rëndësime rritje e sigurisë dhe kemi nevojë që të realizojmë projekte të tilla, kërkesa ime është:

1. Ndriçim publik

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 19:10

Kërkesat e qytetarëve të pranuar në formë elektronike:

23.07.2024 Celi Murselaj-Bellushë

1. Rruga kryesore Poslisht Billushe është në gjendje të mjerueshme andaj ju lus që të merrni masa për pastrimin e rrugës.
2. Pastrimi i varrezave të fshatit
3. Shqetësimi kryesor që mbetet për neve si banorë të fshatit Billushe është mungesa e ujit të pijes.
4. Kërkojmë ndërtimin e stadiumit të fshatit.

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra---:1

Meshkuj:24

Totali---:25

Projekt buxheti për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, u është prezantuar qytetarëve të pranishëm në dëgjim edhe përmes video projektorit si dhe u është shpërndarë edhe në formë fizike.

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe planifikimet për vitet 2026/2027, mund ta gjeni të publikuar edhe në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-te-Zhurit-2025-2027.pdf>

Lami për mbajtjen e dëgjimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-planifikon-te-realizon-projekte-cilesore-ne-rajonin-e-zhurit-dhe-vlashnjes/>

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik në Vlashnje Hoçë e Qytetit, Jeshkovë, Malesi e Vërrinit, Poslisht, Billushë, Vlashnje, Kobaj, Grazhdanik, Atmaxhë

Me datë: 10.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/7-Njoftim-per-degjim-buxhetor-me-banor-te-fshatrave-H-Qytetit-Jeshkove-M-Vrrinit-PoslishtBillush-Vlashnje-Kobaj-Grazhdanik-Atmaxhe-Vlashnje-1.pdf>

Me 10.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:
<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshtrave-hoce-e-qytetit-jeshkove-malesi-e-verrinit-poslisht-billushe-vlashnje-kobaj-grazhdanik-atmaxhe-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pe/>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 19:30

Ymer Berisha, udhëheqës i njësisë për komunikim me publikun, sikurse edhe në dëgjime të tjera edhe në këtë takim, jemi për ti marrë kërkesat që ju i keni dhe që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës tuaj. Mirë do të ishte që kërkesat ti renditni sipas prioriteteve që ju keni dhe më pas sipas mundësisë buxhetore ato kërkesa të hynë në buxhetin e vitit 2025.

Zyrtarët përgjegjës, janë duke mbajtur shënime për kërkesat që ju bëni dhe më pas do të hartojnë procesverbal dhe raport për mbajtjen e këtij dëgjimi dhe të njëjtit do të publikohen në webfaqe e ku ju më pastaj mund ti shihni se cilat kërkesa kanë hy në buxhetin e vitit 2025.

Shaqir Totaj, kryetari i komunës i ka përshëndetur dhe falënderuar të gjithë të pranishmit në dëgjime publike. Jemi këtu për ti marrë kërkesat ose më mirë me thënë nevojat që ju i keni, sigurisht që kërkesat janë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore, por që ne do të mundohemi që projektet të futen në buxhet sipas prioriteteve dhe numrit më të madh të banorëve të cilët përfitojnë nga realizimi i projekteve të ndryshme.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe Financa ka thënë se ministria e financave na ka vë limitet buxhetore për buxhetin e vitit 2025 dhe ky projekt buxhet është i ndarë në disa kategori buxhetore dhe se buxheti total do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Reshit Bytyqi- Hoqe e Qytetit, ne kemi bërë kërkesa të cilat janë të rëndësishme për banorët prej nga vij unë dhe ato kërkesa janë për realizimin e projekteve që janë në të mirë të gjithë banorëve që jetojnë në këtë pjesë. Për vitin 2025 kërkesat janë:

1. Përfundimi i disa rrugicave dhe kanalizimeve

2. Hapja e vijave te kanaleve për ujitje
3. Hapja e rrogave fushore
4. Rregullimi i shkollës dhe sallës se edukatës fizike
5. Renovimi i shtëpisë se kulturës

Petrit Hoxhaj- fshati Vlashnje, realisht drejtorët e drejtorive na përgjigjen në kërkesat që kemi dhe ato kërkesa janë të një rendisë të madhe për banorët, për buxhetin e vitit 2025 kërkesat janë:

1. Ndërtimi i sallës se futbollit
2. Rregullimi i objektit shëndetësor

Nexhat Gashi-fshati Atmaxhe, për vitin 2025, kërkesat janë:

1. Rregullimi i kulmit të shkollës
2. Mirëmbajtja e rrugëve fushore

Florim Gashi-Drejtori i shkollës-fshati Billushe

1. Rregullimi i stacionit te fshatit
2. Vendosja e ujësjellësit dhe furnizimi me ujë te pijes
3. Rregullimi i rrugës duke lidhur fshatrat Poslisht, Hoqe e Qytetit dhe Rajonin e Vrrinit

Luljeta Gavazaj Drejtori i shkollës- fshati Vlashnje

1. Kyqja e rrymës ne shkolle

Shpejtim Canaj- fshati Lubiqeve, për banorët e kësaj ane e rëndësishme është që të investohet në projekte që prek direkt mirëqenien e tyre, për vitin 2025, kërkesat janë:

1. Hapja e rrugës qe lidhe fshatrat e Opojes
2. Pastrimi i përroskave
3. Renovimi i lapidarit
4. Rruga Lubiqeve-Jeshkove
5. Hapja e rrugëve fushore
6. Ndriçimi publik
7. Ndërtimi i stadiumit

Izet Osmanaj- fshati Kobaje, do të jemi i shkurtër në prezantimin e kërkesave e që janë të rëndësishme dhe që janë:

1. Ndërtimi i rrugës qe lidh fshatin Kobaj me Bajram Curr
2. Ndriçimi publik ne fshat
3. Rrethoje e shkollës

Agron Halimi- fshati Poslisht

1. Ndriçim publik

Alfons Boqaj- fshati Grazhdanik , për banorët e fshatit është e rëndësishme që të punohet, realizohen projekte infrastrukturore dhe se për vitin 2025, kërkesat janë:

1. Përfundimi i rrugës qe lidh fshatin Kobaje me Grazhdanik
2. Ndërrimi i gypit te azbesit
3. Ndriçim publik

4. Ndalim i hedhjes se mbeturinave

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 20:25

Kërkesat e qytetarëve të pranuar në formë elektronike: Është pranuar një kërkesë.

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra----:2

Meshkuj:12

Totali---:14

Projekt buxheti për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, u është prezantuar qytetarëve të pranishëm në dëgjim edhe përmes video projektorit si dhe u është shpërndarë edhe në formë fizike.

Projekt buxhetin :

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekti-buxheti-per-Vlashnje.pdf>

Lami për mbajtjen e dëgjimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-planifikon-te-realizon-projekte-cilesore-ne-rajonin-e-zhurit-dhe-vlashnjes/>

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me gra, buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistët dhe OJQ

Me datë: 24.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/8-Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionist-dhe-OJQ.pdf>

Me 24.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionist-dhe-ojq/>

Me 13.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për gra buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistët dhe-OJQ:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-me-gra-buxhetimi-gjinor-te-rinje-pensionistet-dhe-OJQ.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 18:10

Dëgjimi buxhetor me gra, buxhetimi gjinor, të rinjë, pensionistët dhe OJQ i mbajtur me datë 08.08.2024.

Hapjen e dëgjimit është bërë nga Ymer Berisha, Udhëheqësi i Njesisë për Komunikim me Publikun i cili ka thënë se kemi jemi në këtë dëgjim buxhetorë që t'ju dëgjojmë kërkesat që ju i keni, sigurishtë që zyrtarët përgjegjës do të majnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe raport të detjashëm për mbajtjen e këtij dëgjimi. Fjalën fillimisht do të marrë kryetari, pastaj drejtori i financave do të bëjë prezantimin e buxhetit dhe më pas ju qytetarë të nderuar do të keni mundësinë që ti bënë kërkesat tuaja.

Shaqir Totaj, kryetar i komunës, ka thënë në këtë dëgjim ne do ti marrim kërkesat që ju i keni dhe më pas ato kërkesa do të futën në buxhetin e vitit 2025 dhe gjithashtu në buxhetin e viteve 2026 dhe 2027, pasi që disa kërkesa do të realizohen në vitin 2025 e disa në vitet në vazhdim. Mundësitë buxhetore janë këto që janë dhe nuk ka mundësi që të realizohen të gjitha kërkesat pasi që buxheti nuk mjafton.

Sulltan Badalli, drejtor për Buxhet dhe financa, buxheti i komunës është dokumenti më i rëndësishëm i një organizate buxheteore, projekt buxhetin e komunës e kemi përgatitur duke u

bazuar në qarkoren e parë të ministrisë së financave. Buxheti është i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0

Kërkesat e qytetarëve:

Daut Qylangjiu, janë bërë punë të mira, por që ne sigurisht që kemi edhe kërkesa tjera e që mendojmë që janë të rëndësishëm për gjithë banorët, kërkesat e mia janë:

1. Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Nusret Searsoj,
2. Ndërtimin e një qendre kulturore për Romët.

Resmije Krasniqi, duke ju falënderuar për angazhimin tuaj, kisha kërkuar që të ketë buxhet më shumë nëpër drejtori dhe kërkesat e mia janë këto:

1. Dyfishimi i buxhetit për Drejtorin për Mirëqenia Sociale
2. Krijimin e një hapësirë (local) për promovimin e punimeve të shoqatës Hader.

Shyret Hoxha, e kërkesat e mia që besoj që do të hynë në buxhetin e vitit 2025 janë këto:

1. Ndriçimi dhe rregullimi i rrugës Edit Durham,
2. Ndriçimi publik në lagjen Jeta e re,
3. Kubzimi i rrugëve Justiniani dhe At Mejdan,
4. Rregullimi i rrugës Janina.

Linda Simitçiu, si OJQ jemi falënderuar për punën e bërë por që mirë është që të planifikohet investim edhe në këtë dy objekte e që mendojmë që janë të një rëndësisë të veçantë:

1. Rregullimi i qendrës rinore në Ortakoll,
2. Rregullimi i bunkerit në lagjen Ortakoll.

Osman Osmani OJQ-Nevo Koncepti, duke ju falënderuar për gjithë angazhimin tuaj që po bëni për komunitetin tonë, kisha kërkuar që ti realizoni edhe këto kërkesa pasi që janë të rëndësishme për komunitetin Romë:

1. Hapja e çerdheve dhe klasave në edukim të hershëm,
2. Punësimi i një përkthyesi për gjuhën romë.

Dëgjimi ka përfunduar në orën 18:50

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra----:9

Meshkuj:17

Totali---:26

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund ti gjeni në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund ti gjeni ne këtë vegez:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit të përgjithshëm-përfundimtarë me qytetarë dhe kryetar të këshillave të fshatrave dhe lagjeve

Me datë: 24.07.2024, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/10-Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-te-pergjithshem-me-qytetare-kryetar-te-keshillave-te-fshatrave-dhe-lagjeve-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025.pdf>

Me 24.07.2024, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-te-pergjithshem-me-qytetare-kryetar-te-keshillave-te-fshatrave-dhe-lagjeve-per-pergatitjen-e-buxhetit-per-vitin-2025/>

Me 26.07.2024, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 i përgjithshëm-përfundimtarë me qytetarë dhe kryetar të këshillave të fshatrave dhe lagjeve :

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-buxheti-per-i-pergjithshem-me-qytetare-dhe-kryetar-te-keshillave-te-fshatrave-dhe-lagjeve.pdf>

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 10:07

Hapja e dëgjimit është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqësi i Njesisë për Komunikim me Publikun, i cili ka thënë se dhe sot sikur se edhe në dëgjimet tjera që mbajtura ne do ti dëgjojmë kërkesat tuaja që i keni dhe më pas ato kërkesa sipas prioriteteve do të hynë në buxhetin e vitit 2025. Për dëgjimin e mbajtur sot, do të mbahet shënime nga zyrtarët përgjegjës dhe më pas do të hartohet procesverbal dhe raport me të gjitha detajet, të njëjtit do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës, dhe të gjithë të interesuarit mund të shohin se cilat kanë qenë kërkesat dhe cilat kanë hy në buxhet dhe cilat nuk kanë hy në buxhet.

Shaqir Totaj, kryetari i komunës, në fillim i ka përshëndetur gjithë të pranishmit duke u thënë se e vlerësoj shumë prezencën tuaj në dëgjim. Ky dëgjim është për t'ju dëgjuar kërkesat që ju keni, realisht kjo na lehtëson punën gjatë përgatitjes finale të buxhetit për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027. E kam parasysh që kërkesat janë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore, por që disa kërkesa hynë në buxhetin e vitit 2025, disa në të viteve 2026/2027. Të gjitha kërkesat janë të arsyeshme, por që mundësitë buxhetore janë të kufizuara dhe nuk ka mundësi që të realizohen të gjitha kërkesat që ju i keni.

Sulltan Badalli, drejtor për buxhet dhe financa ka thënë se buxheti i komunës së Prizrenit bazohet në qarkoren që e dërgon ministria e financave, ajo qarkore na i vendos edhe limitet buxhetore, për vitin 2025 buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në kategori si në vijim: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0.

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Pelivan Pulaj, kryetar i lagjes Bajram Curr, kërkesat dhe arsyetimet:

- 1.Ndertimi i kanalizimit dhe asfaltimi i njeve kryesore te lagjes, rr.Ylber Fanaj, rr.Liman Shala dhe rr. Mbreti Pleurat.
- 2.Ndertimi i një parku tek KFOR-I TURK, ku i kemi evidentuar rreth 11 ari-prone e Komunës se Prizrenit.
- 3.Ndertimi i një aneksi shkollor tek Shkolla Fillore “Fatmir Berisha”, pasi qe çdo vit e me tepër po rritet numri i nxënësve për shkak te lëvizjeve te qytetareve nga fshatrat ne qytet dhe hapësirat e shkollës nuk e përballojnë këtë fluks te nxënësve te rijnë.
- 4.Ndertimi i një rreth-rrotullimi ne Rrugën e Kukesit, tek ish-Farmakosi, ku lidhet me rrugën e re qe te dërgon drejt urës Bajram Curr-Tusuz .
- 5.Rregullimi i shtratit te Lumbardhit nga Ura e Xhevis (ura tek Elkosi) ne drejtim te Vlashnjës, pasi qe po rrezikohen shume shtëpi nga përmbytjet.
- 6.Hapja e një rruge nga Kompleksi i Shkollave, ne drejtim te ELKOSIT, meqe egzsitojne si te parapara ne planin urbanistik dhe kjo rruge do ta lehtësonte qarkullimin e nxënësve, prindërve por edhe vet banoreve.
- 7.Hapja e rrugës nga Viva Fresh Store, ne drejtim te KFORIT Turk, ku është pamundësuar shkaku i një muri ekzistues. Këtë rruge e keni vizituar edhe vet ju kryetar ne vitin 2021 dhe do te ndikonte ne lehtësim te komunikacionit.
- 8.Ndertimi i mega projektit te kanalizimit ne rrugën Brigada 125, projekt ky mbi 3 km, për te cilin është i njoftuar edhe drejtori i Shërbimeve Publike, pasi qe aty jetojnë mbi 50 shtëpi te banueshme.
- 9.Kanalizimi dhe kubezimi i rrugës qe shpie nga Mbreti Pleurat ne drejtim te rrugës se Nashecit, e cila është vetëm e shtruar me zhavorr dhe është bere e pakalueshme për dhjetëra familje.
- 10.Instalim i ri dhe riparim i rrjetit te ndriçimit publik ne tere lagjen.
- 11.Trajtimi i qenve endacak.

Bajram Kastrati, lagjja Arbana-Prizren

- 1.Nyjet sanitare ne shkollen "Ibrahim Fehmiu", ne Arbane.
- 2.Nderrimi i dyerve dhe dritareve ne shkollen "Ibrahim Fehmiu", ne Arbane.
- 3.Ajrimi (klimatizimi), sistemi i ngrohjes dhe freskimit te ajrit ne shkollen "Ibrahim Fehmiu", ne Arbane
- 4.Izolimi i kulmit te shkolles "Ibrahim fehmiu", ne Arbane.
- 5.Rrethimi i varrezave te Arbanes.
- 6.Instalimi i ndricimit ne rruget qe jane te ndertuara, qe skane ndricim ne Arbane dhe ne qytet.
- 7.Nderrimi i te gjitha qative brenda qytetit dhe fshatrave qe jane te mbuluara me asbest.
- 8.Ndertimi i sistemit per furnizim me uje te pijes ne rruget e Arbanes.

Behar Berisha

Unë i kam katër kërkesa e të cilat janë secila me e rëndësishme se tjetra, dhe nëse realizohen këto kërkesa që kanë të bëjnë me fshatin Lez do të ishte shumë mirë pasi që vërtet janë të nevojshme:

1. Renovimi i Lapidarit të Dëshmorëve
2. Asfaltimi i rrugës për fshatin Lez
3. Rregullimi i dokumentacionit Kadastral
4. Hapja e rrugës Malësi e Vërrinit - Lez

Arben J. Krasniqi

1. Kërkesë për asfaltimin e rrugës Ali Pash Guçia

Rrjeti i OShC-ve- lagjen Terzi Mahallë (Nysret Seharoj) Prizren, realizimi i këtyre kërkesave është shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj lagjeje, andaj më poshtë mund ti gjeni kërkesat tona:

- 1.Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit
- 2.Rregullimi i kanalizimit të ujërave të zeza
- 3.Rregullimi i rrugëve me kubëza
- 4.Rregullimi i rrjetit të rrymës dhe operatorëve kabllor

Bekim Thaqi- përfaqësues i Fshatrave Caparc dhe Novak

Shtrim të rrugicave 1000 metra

Shtrim të rrugëve fushore 2000 metra

Shtrim të trotuareve 1000 metra

Rregullimi i parkut te qendra e fshatit Caparc 180 m2

Ymrane Fusha-Prizren, më poshtë mund të gjeni kërkesat të cilat janë si nevoja të qytetarëve që jetojnë në këtë lagje e që kanë të bëjnë me investime në infrastrukturë:

- 1.Investim në shkollën "Motrat Qiriazit" nderimin e dyerve dhe dritareve ,të rinovohet salla e edukatës fizike ,një renovim total i shkollës.
- 2.Të bëhet qasja nga Dardania 2 me një urë te rruga Qazim Berisha ,ku egziston infrastruktura (kanalizimi) .
- 3.Të ndërtohet një terren sportiv në lagjen Kurrilla (Bajer).
- 4.Të ndërtohet një çerdhe në lagjen Kurilla
- 5.Rregullimi i infrastrukturës me kanalizim në rrugën "Jakup Muqeziu".
- 6.Mundësisht të jepet në shfrytëzim një lokal grave të Prizrenit dhe të rajonit ,për promovimin e produkteve artizanale.
- 7.Një lokal mundësisht të jepet në shfrytëzim shoqatës "GRATË E DËSHMORËVE"

Ilami Axhillari, Kryetari i Këshillit Lokal të lagjes “10 Qershori” në Prizren

Propozimi 1:

Ish Konvikti i Studentëve (Internati) afër fabrikës së barnave Farmakos (Farmakosi i vjetër) në Prizren

Në lagjen „10 Qershori“ ekziston objekti i cili më parë ka shërbyer si konvikti i nxënësve dhe studentëve, ndërsa që nga lufta e këndej po shfrytëzohet si qendër ku janë në vendosura familjet të cilat i kanë humbur shtëpitë e tyre gjatë luftës në Kosovë. Objekti është menjëherë përballë fabrikës së barnave „Farmakos“.

Kërkesë nga lagjia është që Komuna e Prizrenit të intervenoj në renovimin e ndërtesës për ta përdorur për qëllime të ndryshme çoftë komunale ose qëllime tjera për të cilën e destinon Komuna. Në kuadër të këtij objekti, në pjesën perëndimore të tij, ekziston një hapsirë mjaftë e gjerë, me sipërfaqe diç më shumë se 30 ari. Pothuaj tërë kjo hapsirë është e pashfrytëzuar. Ndërtimi i fushave të ndryshme sportive në të, do të ndihmojë banorët e të tri lagjeve (“10 Qershori”, “Vëllezërit Stavileci” dhe “Lidhja e Prizrenit”) të kenë qasje më të afërt në terrene sportive ku rinia por edhe moshat e tjera mund të zhvillojnë aktivitete sportive dhe rekreative më afër shtëpive të tyre.

Në këtë hapsirë në nivelet -1 dhe -2 (mbase edhe -3) mund të ndërtohet edhe parking nëntokësor dhe marrë parasysh afërsinë me qendrën e qytetit do të ndikojë pozitivisht për banorët që do të parkojnë makinat aty por edhe për turistët që e vizitojnë qytetin.

Kjo kërkesë është njëherit edhe kërkesë e shumicës së banorëve të këtyre lagjeve të qytetit. Në rast se këto kërkesa pranohen, banorët e këtyre pjesëve të qytetit do të jenë shumë mirënjohës ndaj Komunes së Prizrenit.

Rëndësi shumë e madhe për banorët në renovimin dhe shfrytëzimin publik të kësaj hapsire është aspekti i sigurisë. Ka kohë të gjatë që kjo hapsirë paraqet rrezik për sigurinë e banorëve. Aty nuk dihet kush hyn dhe del. Natën është zonë e pandriçuar dhe ka potencial për keqpërdorim nga delikuentë kriminal lidhur me substancat narkotike. Grumbullimi i qenve endacakë për shkak të mbeturinave që grumbullohen brenda hapsirës dhe jashtë saj, është një tjetër kërcënim serioz për banorët.

Propozimi 2:

Në rrugën Anif Muji, në vendin e quajtur “Bylbyldere”, muri mbrojtës për katër shtëpi ka filluar të shembet dhe paraqet rrezik për banorët dhe kalimtarët e rastit, sisomos paraqet rrezik për rrëshqitjen e dheut që do të rrezikonte ç’vendosjen, gjegjësisht, shembjen e 5 shtëpive.

Kërkohet që Komuna e Prizrenit të intervenojë në sanimin e këtij muri pasi muri ekzistues e siguron rrugën që është rrugë publike. Lartësia e murit nga pjesa më e lartë është rreth 3m ndërsa gjatësia e murit është rreth 30m.

Propozimi 3 (bylbyldere ,nënkalaja):

Të intervenohet në ndriqimin publik në Rrugët:

1. “Xhavit Bajraktari”, “Saraji” Anif Muji”,
2. “Nuhi Elezi”
3. “Pal Paluca”
4. “Mentor Krasniqi”

5. “Anton Çetta”
6. “Lazër Lumezi”
7. “Shën Albani”
8. “Themistokli Germenji”
9. “Shën Jeronimi”

Propozimi 4 (nënkalaja):

Rregullimi i rrugëve, trotuareve, infrastrukturës nëntokësore, ndërtimi i pushimoreve dhe vendosja e disa ulëseve në rrugët (të gjitha bashkë me gjatësi rreth 700 m):

1. “Pal Paluca”
2. “Mentor Krasniqi”
3. “Anton Çetta”
4. “Lazër Lumezi”
5. “Shën Albani”

Është me rëndësi që në disa vende të këtyre rrugëve të vendosen mbështetëset anësore për këmbësorë për shkak të pjerrtësisë të madhe të terrenit dhe rrezikut të lëvizjes së njerëzve të moshuar.

Propozimi 5 (nënkalaja):

Ç’vendosja e shtyllave elektrike në vendet në të cilat ato gjenden në mes të rrugës.

Propozimi 6 (ish farmakosi i barnave) – “Bylbyldere”

Rregullimi i kanalit (procke) për mbledhjen e ujrave atmosferik me gjatësi 250 m,

Rregullimi i dy rrugëve me kubëza betoni, infrastrukturës nëntokësore me gjatësi rrethë 300 m²,

Rregullimi i trotuarëve jo më shumë se 200 m²,

Rregullimi i pusetave (ujëmbledhsave-grila), nr. 4 puseta,

Rregullimi-Riparimi i rrugëve me kubëza betoni 100 m².

1. “Anif Muji”
2. “Xhavit Bajraktari”.

Shukrije Berisha-Kryetare e Lagjes “Vëllezërit Stavileci”

1. Funkcionimi i një tregu mbrapa gjimnazit “Gjon Buzuku” aty ku ka qenë më herët në mënyrë që t’ju lejohet lagjes lëvizja e lirë, në veçanti për më shumë se 2000 nxënës të shkollës fillore “Mustafa Baku” dhe gjimnazit “Gjon Buzuku”.
2. Kubëzimi i trotuarit në lagjen “Vëllezërit Stavileci”
3. Ndërtimi i gypave të ujit pijes pasi që janë rrezikshëm për shëndetin e banorëve
4. Funkcionimi lokalit për pensionist në lagjen tonë.

Admir Rama

Fushat e Tenisit në Qendrën Sportive "Sezai Suroi",.

Meqenëse në këtë lokacion kemi dy fusha ekzistuese dhe që Prizreni si një qytet me bagazh historik, kulturor, artistik duhet të begatoj edhe sportin në këtë rast Tenisin. Prizreni që të jetë nikoqir i ndonjë ngjarje ose gare ndërkombëtare duhet të ketë infrastrukturë, meqenëse tani i kemi dy fusha të tenisit që duhet të mbulohen por, për me qenë kompetitivë dhe për të përmbushur minimumin kriterijumit që të jemi nikoqir i ndonjë gare evropiane ose ndërkombëtare sipas rregullave të ITF duhet ti kemi minimum katër fusha të tenisit, andaj do ishte një vlerë e shtuar për qytetin e Prizrenit që të ndërtoj edhe dy fusha shtesë të Tenisit ngjit me ato ekzistuese në Qendrën Sportive për të mirën e sportit, për të mirën e Tenisit për të mirën e Prizrenit.

Projekti infrastrukturor në Fshatin Mushnikovë në lagjën e re në hyrje të Mushnikovës, muri mbrojtës, kubzim, ndriçim dhe gjërat e nevojshme!

Meqenëse në këtë lagje janë të ndërtuara më shumë se 10 shtëpitë dhe kanë nevojë për përmirësim të infrastrukturës do ishte e mirëseardhur që të trajtohet kjo kërkesë me seriozitet për tu realizuar, dhe për tu lehtësuar jetën e qytetarëve, kërkesa parashtrohet në bashkërendim me banorët e kësaj lagje të re.

Dok Nrekaj – Karashingjergj- Më duhet të ju them se në fshatin prej nga vij unë është investuar si kurrë më parë, janë shtruar rrugë e rrugica po thuajse në gjithë fshatin, por nëse kishit pasur mundësi që ti realizoni edhe dy kërkesa që i kam e që janë në të mirë banorëve që jetojnë në afërsi të dy rrugëve do t'ju ishim mirënjohës:

1. Shtrimi i asfaltit i Lagjes Cakaj
2. Shtrimi me asfalt i rrugës prej kishës

Lulzime Shemollari Topalli – Struzhe, jam caktuar që të vij dhe të përfaqësoj banorët e fshatit dhe ti paraqes kërkesat që ata kanë e që janë shumë të nevojshme, kërkesat janë:

1. Mirëmbajtja e rrugës në fshatin struzhe
2. Rregullimi i shtyllave të rrjetit elektrik
3. Vendosja e murit mbrojtës dhe heqja e murit të rrezuar.

Hamz Gashi-Dushanove, kërkesat e mia kanë të bëjnë me shkollën e lagjes Dushanovë, vërtet duhet të intervenohet sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që nxënësit të kenë kushte më të mira për mësim, kërkesat janë:

1. Ndërrimi i dyerve të shkollës,
2. Ndërrimi i dritareve të shkollës,
3. Rregullimi i ventilimit për ajrosje të shkollës,
4. Ndërrimi i kulmit të shkollës.

Haki Reshtana

1. Investime ne ndërtesën e shoqatës se penzionerave,
2. Rregullimi i shtratit te mullirit te qytetit.

Shukri Quni-Nashec – Grazhdanik

1. Ndërtimi i sallës sportive ne Nashec
2. Hapja e kanale te ujitjes ne Grazhdanik.

Ruzhdi Ajazaj- Petrovë

1. Renovimi i shkolles se fshatit,
2. Rregulli i rrjetit nga ana e Kekut.

Besmir Shala – Billush, kërkesat e mia janë edhe nevoja të banorëve të fshatit, andaj

1. Rruga nga Poslishti dhe Hoqa te lidhen me qytetin qe te shkarkohet kolona
2. Ndërtimi i stadiumit te fshatit
3. Ndërrimi i ujësjellësit dhe kanalizit ne fshat
4. Furnizimi me ujë te pijes

Shpetim Canaj – Lubiqeve

1. Hapja e rrugës malore qe lidhet me fshatrat e Opojes.
2. Hapja e rrugës për ne fshatin Arberi
3. Shtuarja e rrugës për ne fshatin Lez
4. Rregullimi i kthesës ne hyrje te fshatit pasi qe paraqet rrezik
5. Mjeku te punoj çdo dite ne fshat

Sherif Gashi – Landovic

1. Rregullimi mi shtratit te lumit te fshatit edhe për 50 metra ne afërsi te hekurudhës

Ali Berisha - lagjja Xhevat Berisha

1. Rruga dardanet rregullimi i trotuarit ne krahun e djathte te rrugës ne drejtim te lumit, dhe vendosja e murit mbrojtës sipas nevojës, dhe zgjerimi i ktheses qe lidhet me rrugën Xhevat Berisha.
2. Rruga Naip Berisha - ndërrimi i kubzave dhe dritave, ndërrimi i gypave te ujit pasi janë te azbesit dhe paraqet rrezik.
3. Rruga Ryfet Berisha – renovimi i kubzave.
4. Rruga Rrilet – shtrimi me kubeza pasi qe e vetmja rruge është e shtruar me zhavor.
5. Rruga Flamuri ndërrimi i kubzave, rrjetit te ujit dhe kanalizimit
6. Rruga Pishtarët e Lirisë – Ndërrimi i kubzave dhe ndriçimi publik.
7. Rruga Istikamet diku rreth 70 metra te shtrohet me kubza e cila lidhet me rrugën Nesim Krasniqi
8. Vendosija e ulëseve tek memoriali martiret e tusuzit.
9. Furnizimi me ujë i Lagjes se UQK ku qe 25 vite nuk ka furnizim dhe uji nga puset nuk është i përdorshëm.

Numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë:

Femra---:5

Meshkuj:60

Totali---:65

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 11:25

Përfundimi:

Komuna jonë me kohë dhe brenda afateve ligjore ka formuar grupin punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2025-2027 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2025, po ashtu kemi hartuar me kujdes të shtuar kalendarin shtrirjen horizontale të dëgjimeve buxhetore në teritorin e komunës së Prizrenit, si në zonat rurale ashtu edhe në qytet.

Kemi planifikuar t'i organizojmë 10 dëgjime buxhetore dhe të gjitha janë organizuar sipas objektivave të planifikuara, pjesë marrja e qytetarëve në dëgjime ka qenë relativisht e kënaqshme, ne si komision kemi analizuar përmes sistemit të swot analizës, realizimin e dëgjimeve buxhetore dhe kemi pranuar kthim informacion për nevojat, që viteve në vijim dëgjimet buxhetore të organizohen sa më mirë dhe më pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve të komunës sonë.

Për të gjitha dëgjimet kemi ruajtur kujdesin që të hartojmë procesverbalet me kërkesat e bëra nga ana e qytetarëve të pranishëm në dëgjim dhe në fund fare kemi hartuar edhe raportin final me të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe ne si komunë u jemi përgjigjur në formë të shkruar në raport pranimit të kërkesave, refuzimit ose të pranuar pjesërisht.

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi